



Pranuar / Dorezuar Prijeto / Predato Received / Delivered	05.12.2023	viti god Year	3
Organ / Ujesta Organ / Jednica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtetja e Prileg Apudix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMESHUK	7229/2023		1/7



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1285/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1289/2023 të datës 13.10.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë: Rruga [redacted] kundër Vendimit me numër Nr.18/2023 të datës 11.10.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 04.12.2023 mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1285/2023, e datës 13.10.2023, e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër Nr.18/2023, i datës 11.10.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenin 34 (2 dhe 3) dhe nenin 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranim dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht më datë 09.08.2023 ka njoftuar lidhur me konkursin me numër reference Nr.RN00012281, për grupin „Specialistë të Farmaceutikës”, për pozitën e punës „Inspektor Farmaceutik” në Inspektoratin Farmaceutik/Ministria e Shëndetësisë, ku afati për aplikim ka qenë nga data 08.09.2023 deri më 18.09.2023.

Në bazë të listës së aplikacioneve në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja me kodin me numër Nr.RAN0017847, ndërsa më datë 03.10.2023 Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.08/2023 përmes së cilit ankueses i është refuzuar aplikacioni, me arsyetimin se e njëjta nuk ka ofruar dëshmi të kërkuar sipas Konkursit me numër reference Nr. RN00012281, konkretisht dëshimtë mbështetëse pasqyrën në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhura pensionale.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me numër Nr.08/2023 të datës 03.10.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, më datë 03.10.2023 përmes portalit elektronik ka parashtruar ankesë në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa më datë 11.10.2023 Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.18/2023 përmes së cilit e ka refuzuar ankesën e parashtruar nga ankuesja si të pabazuar.

Kundër Vendimit me numër Nr.18/2023 të datës 11.10.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në kuadër të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, më datë 13.10.2023 përmes emailit zyrtar [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net), ankuesja ka parashtruar ankesë me numër protokollit Nr.prot.6537/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 19.10.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli më datë 23.10.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë e cila është protokolluar me numër protokollit Nr.1285/2023 së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me Vendimin me numër VK/2023 dhe numër të protokollit 7119/2023 të datës 27.11.2023 ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.1285/2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit Nr.prot.6537/2023 të datës 13.10.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 03.10.2023 të parashtruar nga ankuesja në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme; Pasqyra e Llogarisë së Trustit Pensional për periudhën kohore 01.08.2023 deri më 12.05.2023; Letrën e rekomendimit maj 2023 të lëshuar nga Drejtoresha e Barnatores Chamomila; Konkursin me numër reference Nr.RN00012281 të datës 08.09.2023; Vendimin me numër Nr.18/2023 të datës 11.10.2023; Vendimin me numër Nr.08/2023 të datës 03.10.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses të datës 19.10.2023; Përgjigjen në kërkesë të protokolluar me numër protokollit Nr. 1285/2023 më datë 23.10.2023; Vendimin me numër Nr.01/161 të datës 25.09.2023 për themelimin e Komisionit të Pranimit; Listën e aplikantëve në pritje; Listën e aplikantëve të aprovuar; Njoftimin e datës 03.10.2023; Aplikacionin; Diplomën me numër Nr. 3466 të lëshuar nga Universiteti i

Prishtinës më datë 13.12.2023; Dëshminë për pjesëmarrjen në Konferencën Ndërkombëtare të Farmacisë; Dëshmi për pjesëmarrjen e dytë II të Farmacisë; Certifikatën e datave 08-10 korrik 2021; Kopjen e letërnjoftimit; Deklarata nën betim e datës 01.09.2023; Kopjen e Pasaportës; Certifikatën 03.09.2022 të lëshuar nga Oxford; Certifikatën mbi denimet penale të datës 19.05.2023; Licencën e punës të datës 22.03.2023 të lëshuar nga Oda e Farmacistëve të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses

*është e pabazuar, sepse:*

Ankuesja në ankesën me numër protokoll Nr. prot.6537/2023 të parashtruar më datë 13.10.2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër Nr.18/2023 të datës 11.10.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit, pretendon se, është shkelur Rregullorja me numër Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbim Civil, gjithashtu është bërë shkelje edhe e Ligjit me numër Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Ligjit me numër Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë si dhe vet Konkursit me numër reference Nr. Nr.RN00012281, për grupin „Specialistë të Farmaceutikes“, për pozitën e punës „Inspektor Farmaceutik“ në Inspektoratin e Farmaceutikës/Ministria Shëndetësisë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses ka konstatuar se, kërkesat e përgjithshme formale të konkursit me numër reference Nr.RN00012281, për grupin „Specialistë të Farmaceutikës“, për pozitën e punës „Inspektor Farmaceutik“, klasa e pozitës Profesional 1, në Inspektoratin Farmaceutik/Ministria e Shëndetësisë, kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve në fushat; Farmaci, Inxhinieri Farmaceutike, Inxhinieri Kimike me Specializim, Farmaceutikë;*
- *Kualifikime të posaçme formale: licencë për ushtrim të pavarur të veprimtarisë shëndetësore;*
- *Përvoja e punës: Se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës.*

Ndërsa në pikën 7 të këtij konkursi si dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim janë: *Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, nostrifikimin apo aktin që dëshmon se diploma e marrë jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit; Kopjet e dëshmisë së punësimit të cilave u bashkangjitet njëra nga dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore për të ardhurat personale (vërejtje: nuk vlen vetëm vërtetimi dhe apo vetëm dokumenti mbështetës, është i nevojshëm ngarkimi në sistem i të dy llojeve të dokumenteve: vërtetimi si dëshmi kryesore dhe njëra nga pasqyrat si dëshmi mbështetëse); Nuk kërkohet dëshmi mbështetëse për përvojen e punës në sektorin publik; Kopjen e Licencës për ushtrim të pavarur të veprimtarisë shëndetësore; Kopjet e dëshmisë së trajnimeve të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit. Njëra nga këto dokumente është e mjaftueshme; Dëshmi përkatëse se kandidati-ja ka zotësi të plotë për të vepruar (prezantohet nga kandidati-ja nëse ai/ajo përzgjidhet për emërim pas përfundimit të vlerësimit dhe në përputhje me*

rezultatit e arritur); Dëshmi mjekësore se kandidati-ja është në gjendje të mirë shëndetësore për kryerjen e detyrës (prezantohet nëze kandidati-ja përzgjidhet për emërim. Dëshmia duhet të jetë jo më e vjetër se gjashtë(6) muaj; Certifikatë/Vërtetim nga Gjykata ose Këshilli Gjyqësor i Republikës së Kosovës me të cilin dëshmohet se nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit; Nëse kohëzgjatja lidhur me përvojen e kërkuar të punës është në sektorin publik, atëherë është i nevojshëm vërtetimi nga institucioni ku ka punuar kandidati/ja me të cilin dëshmohet se ai/ajo nuk ka një Masë Disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë të zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik; Nëse përvoja e punës e deklaruar është në sektorin privat brenda apo jashtë vendit, në një OJQ brenda apo jashtë vendit apo angazhimi nga i cili rrjedhë përvoja e punës është ndonjë formë e marrëdhënies kontraktuale që nuk nënkupton marrëdhënie pune, atëherë është i nevojshëm një vetdeklarim i nënshkruar se ai/ajo nuk ka një Masë Disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Në kuptim të kërkesave të përgjithshme formale për pranimin e zyrtarëve publikë të paraparë me nenin 8 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht me paragrafin 1, përcaktohet se: "Kërkesat e përgjithshme për pranimin e zyrtarëve publikë janë: 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; 1.2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar; 1.3. të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; 1.4. të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse; 1.5. të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; 1.6. të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji", ndërsa sipas nenit 12 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: "2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e konkurrimit, kandidatët duhet të bashkëngjitin edhe dokumentacionin si në vijim: 2.1. kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore; 2.2. kopjet e dëshmisë së punësimit, dhe 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e konkurrimit dhe të deklaruara në aplikacion".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ndërlidhur me pretendimet ankimore të ankuses dhe në kuptim të analizimit të pikës shtatë (7) të Konkursit me numër reference: RN00012281 për emrin e grupit „Specialistë i Farmaceutikës”, me titull të pozitës „ Inspektor i Farmaceutikes”, i u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë të cilat rregullojnë procedurën e pranimit në Shërbimin Civil, gjegjësisht nenit 34 të këtij ligji me të cilin është përcaktuar se: 1. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, pranimi në Shërbimin Civil bëhet në kategorinë profesionale në grupin e administrimit të përgjithshëm dhe në secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 2. Pranimi në kategorinë profesionale bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur dhe publik. Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike dhe sipas nevojave dhe së paku një herë në vit, për grupin e administrimit të përgjithshëm dhe për secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 3. Konkurrimi organizohet nga DMZP për institucionet e administratës shtetërore dhe nga Njësia e Burimeve Njerëzore për çdo institucion tjetër (në tekstin në vijim: njësia përgjegjëse). 4. Njoftimi për hapjen e procedurës të konkurrimit shpallet në një afat jo më të shkurtër se 21 ditë, nga data e përcaktuar për paraqitjen e aplikimit, nga njësia përgjegjëse, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit të SIMBNJ dhe me mjete të tjera të përshtatshme. Afati për pranimin e aplikacioneve nuk mund të jetë më i shkurtër se 8 dite dhe jo më i gjatë se 15 ditë kalendarike. 5. Shpallja e konkursit, sipas paragrafit 4 të këtij neni, përfshin përshtatshme të punës për grupin përkatës, pozitën e punës të lira në grupin përkatës, kriteret që duhet t'i plotësojnë kandidatët,

afatin për aplikim, të dhënat e hollësishme për zhvillimin e procesit të përzgjedhjes dhe dokumentacionin që duhet paraqitur për aplikim. 6. Konkurrimi zhvillohet në dy faza: 6.1. verifikimi paraprak, nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; 6.2. vlerësimi i njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 7. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia e përgjegjëse, ndërsa vlerësimi i kandidatëve bëhet nga Komisioni i pranimit (në vijim: Komisioni i pranimit), i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë për të cilin zhvillohet konkurrimi....

Bazuar në dispozitat e cekura më lartë, e që kanë të bëjnë me kërkesat për pranim në shërbimin civil, Kolegji i Këshillit, konstaton se në bazë të provave të lëndës, konkretisht dokumentacionit që ka dorëzuar ankuesja, me rastin e aplikimit lidhur me plotësimin e kriterit të kualifikimit arsimor e njëjta ka dorëzuar Diplomën me numër Nr.3466 të lëshuar më datë 13.12.2013 nga Universiteti i Prishtinës me të cilën dëshmohet se ka përfunduar Fakultetin e Mjekësisë/Dega e Farmacisë dhe më datë 30.07.2012 ka marrë titullin Master i Farmacisë, nga rrjedhë se e njëjta ka plotësuar kriterin e vendosur në aspektin e kualifikimit arsimor. Ndërsa, sa i përket kriterit të përvojës se punës si dëshmi të cilat organi i punësimit i ka ofruar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës përmes përgjigjes në ankese e njëjta ka ofruar Letër Rekomandim të lëshuar në muajin Maj 2023 nga Drejtoresha e Barnatores „Chamomila“, me të cilën dëshmohet se e njëjta është e punësuar në këtë barnatore që nga viti 2015 dhe ende vazhdon, po ashtu ankuesja ka dorëzuar Licencën e Punës me shifër RKS-05-0418 për Farmaciste të lëshuar nga Oda e Farmacistëve të Kosovës më datë 22.03.2023 e cila është e vlefshëm deri më 21.03.2028. Tutje sipas shkresave të lëndës rezultojnë se ankuesja ka ofruar edhe Certifikatën mbi Dënimet Penale me numër Nr.ser.2C0FC02EA67F4F8 të lëshuar më datë 19.05.2023 Sistemi Qendror i Evidencës Penale, më të cilin vërtetohet se ankuesja nuk është e dënuar me aktgjykim të formës së prerë, gjithashtu edhe Vetdeklarimin e datës 01.09.2023 me të cilin ka dëshmuar se nuk ka masë disiplinore në fuqi për largim nga një pozitë e zyrtarit publik të pushuar sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ndërsa si dëshmi lidhur me trajnimet profesionale të përfunduara ankuesja ka ofruar, Certifikatën e datës 22-23 Shtatorë 2012 me të cilën dëshmohet se e njëjta ka marrë pjesë në Konferencën e Farmacisë të lëshuar nga Kryetari i Këshillit Organizativ Dr.sc.Z.G; Certifikatën me numër serik 0193 të datës 23-24 Nëntor 2015 me të cilën dëshmohet pjesëmarrja e ankueses në Konferencën Ndërkombëtare të Farmacisë të lëshuar nga Kryetari i Odës së Farmacisë Z.D PHD; Certifikatën me numër 0110 të datës 2-4 Qershor 2017 me të cilën dëshmohet pjesëmarrja e ankueses në Konferencën e II të Farmacisë të lëshuar nga Kryetari i Odës Farmacisë së Kosovës Z.G, PHD; Certifikatën e datës 08-10 Korrik 2021 me të cilën dëshmon se ka përfunduar trajnimin me temën „Advancing Pharmacy Through Education in Bosnia and Herzegovina“ të lëshuar nga IPHARM dhe Erasmus +, si dhe Certifikatën të lëshuar më datë 03.09.2022 të lëshuar nga OXFORD/Shkolla e Gjuhëve të Huaja e cila ka qenë e vlefshme deri më datë 20.12.2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se ankuesja, me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka dorëzuar edhe dokumente apo dëshmi tjera konkretisht: Letër Rekomandim të lëshuar në muajin Maj 2023 nga Drejtoresha e Barnatores „Chamomila“, me të cilën dëshmohet se e njëjta është e punësuar në këtë barnatore që nga viti 2015 dhe ende vazhdon si dhe Pasqyrën e llogarisë se Trustit Pensional për periudhën 01.08.2002 deri me datë 12.05.2023 me të cilat ka

dëshmuar përvojën e punës, mirëpo të njëjtat këto dokumente ankuesja nuk i ka dorëzuar me rastin e aplikimit për emrin e grupit për emrin e grupit „ Specialistë të Farmaceutikës” respektivisht për pozitën e punës „ Inspektor Farmaceutik” të shpallur me datë 08.09.2023 me numër reference: RN00011627 nga Ministria e Punëve të Brendshme, ashtu siç përcaktohet me dispozitat e nenit 12 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku ky fakt është vërtetuar edhe në bazë të dëshmimeve të ofruara nga organi i punësimit gjegjësisht në bazë të aplikacionit të saj e po ashtu edhe në bazë të emalit të datës 04.12.2023 të dërguar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga zyrtarja e DMZP-së \_\_\_\_\_ e cila ka deklarua se sipas kërkesës suaj „Znj. \_\_\_\_\_ nuk ka bashkangjitur dëshmitë mbështetëse si në vijim: pasqyrën e pagesave në fondin e kursimeve pensionale, pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale gjatë aplikimit. Znj. \_\_\_\_\_ e ka bashkangjitur këtë dëshmi (Trust pensional) me rastin e parashtrimit të ankesës”.

Andaj, bazuar në vlerësimin e dëshmimeve si me sipër, dhe fakteve të lartë përmendura rrjedhë së ankuesja nuk ka përmbushur kriteret për të kaluar fazën e verifikimit paraprak ngase nuk ka dëshmuar me prova materiale gjegjësisht nuk ka ofruar dëshmi mbështetëse lidhur me përvojën e punës, respektivisht me rastin e aplikimit kërkohet që kandidatet duhet ti bashkëngjisin përveç vërtetimit si dëshmi nga punëdhënësi që specifikon pozitën, detyrat dhe kohen e angazhimit të tij në atë pozitë, të dorëzojë edhe dëshminë mbështetëse nga Trusti Pensional apo pasqyrën e pagesave të obligimeve tatimore për të ardhurat personale nga Administrata Tatimore e Kosovës, standard ky i cili është vendosur sipas Aktvendimit me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovë, konkretisht përveç vërtetimit si dëshmi kryesore duhet të dorëzohet dhe njërin nga pasqyrat si dëshmi mbështetëse, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se vendimi i kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimi me numër Nr.08/2023, i datës 03.10.2023 dhe Vendimi me numër Nr.18/2023 i datës 11.10.2023 i Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në kuadër të departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik/Ministria e Punëve të Brendshme, është i drejtë dhe i ligjshëm, sepse të njëjtit janë nxjerr në frymën ligjore dhe mbi bazë të gjendjes faktike dhe duke u respektuar kompetenca dhe hierarkia ligjore e përcaktuar me nenin 34 paragrafi 7 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 12 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3, nenin 15 paragrafi 1,2,3,5 dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet së: 1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërliidhen me verifikimin paraprak. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë...” 5.Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katërmbëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 6.Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia

*Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj", dhe po ashtu i njëjti është i arsyetuar në pajtim me dispozitat e nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Theksuar si më sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*Lënda më numër A.nr.1285/2023*

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

*Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional*

Malsore GASHI-BAJRAKTARI  
*Kryetare e Kolegjit*



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.